



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 638/5Prot

Tiranë, më 31.12.2025

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr. 81, datë _31.12.2025

“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Tropojë dhe paralajmërimit të institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës.”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në institucionin Bashkia Tropojë,

VËREJ SE:

Me Urdhrin nr. 638/1, datë 26.06.2025, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Tropojë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin e Bashkisë Tropojë.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet

pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 638/1 Prot., datë 26.06.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Tropojë me shkresën nr. 638/2 Prot., datë 26.06.2025, “*Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Tropojë*”.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për situatën e konstatuar, i cili i është dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 638/4 prot., datë 09.12.2025, të Komisionerit, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes. Rezulton se afati 10 ditor për përgatitjen e observacioneve ka kaluar, dhe nga ana e subjektit të mbikëqyrur nuk është kthyer përgjigje. Nga sa më sipër, duke u konsideruar e plotësuar kërkesa për zbatimin e procedurës në këtë rast, u hartua raporti përfundimtar i mbikëqyrjes.

Gjatë procesit të verifikimit të dokumentacionit në këtë subjekt, janë vërejtur disa mangësi në drejtim të administrimit të shërbimit civil, të trajtuara me hollësi në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ku ndër të cilat janë:

- ✓ Për vitin 2024 nuk është hartuar plani i rekrutimit, ndërsa për vitin 2025, nuk janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit sipas planit të miratuar.
- ✓ Në **27** raste, konstatohet se janë emëruar punonjës në pozicione pune që i përkasin shërbimit civil, duke mos respektuar kërkesat e ligjit dhe procedurat që duhet të aplikohen për institutin e rekrutimit.
- ✓ Janë konstatuar mangësi në procedurën dhe përmbajtjen e proceseve administrative të kryera gjatë rekrutimit, të materializuara në aktet administrative që kanë dalë në përfundim të tyre, ndër të cilat: a) krijimi i mekanizmave që administrojnë procesin e konkurimit në kundërshtim me ligjin, (*Komisioni i Brëndshëm i Lëvizjes Paralele dhe Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë*), b) mungesa e çelësit të përgjigjeve të testimit me shkrim, të cilin anëtarët e Komitetit duhet ta kenë të administruar përpara zhvillimit të testimit me shkrim, e aspekte të tjera të trajtuara me hollësi në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes.
- ✓ Konstatohen mangësi në përmbushjen e detyrimeve që ka institucioni për nëpunësit civilë në periudhë prove, pasi në **3** raste, a) nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër nën kujdesin e të cilit ata do të kryejnë detyrat gjatë periudhës së provës që zgjat 1 vit nga momenti i emërimit; b) nuk është kryer vlerësimi vjetor i punonjësve, si edhe nuk është zbatuar detyrimi që kanë punonjësit për të përfunduar trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA-së, duke mos e finalizuar

në këtë mënyrë procesin me një akt përfundimtar konfirmimi ose jo, të nëpunësit në periudhë prove.

- ✓ Konstatohen mangësi në situatën e administrimit të burimeve njerëzore në strukturën organizative të institucionit, në lidhje me klasifikimin e pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, ç`ka sjell problematikë në ndarjen e saktë të pozicioneve të shërbimit civil nga ato me karakter ndihmës administrativ.

Komisioneri vlerëson se, mangësitë e konstatuara më sipër, duhet të rregullohen dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, e cila e ushtron funksionin në përputhje me të gjitha rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, gjatë veprimtarisë së saj, si dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të angazhuar me detyra të administrimit të shërbimit civil, duhet të zbatojnë kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Bashkisë Tropojë, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën sipas detyrave që do të evidentohen në vijim.
2. Për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në lidhje me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe pikës 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe*

institucionet e pavarura”, i ndryshuar, si dhe duke u bazuar në orientimet e dhëna në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes, Njësia përgjegjëse e institucionit (Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore), duhet të veprojë si më poshtë:

-Të përcaktojë një grup pune, i cili është përgjegjës për mbledhjen e informacionit për pozicionet e punës në strukturën aktuale që janë pjesë e shërbimit civil dhe analizimin e këtij informacioni, në një raport përmbledhës me qëllim përcaktimin e saktë të detyrave, përgjegjësi e kërkesave të veçanta të çdo pozicioni (*përcaktimin e saktë të kërkesave lidhur me nivelin e arsimit, fushën kryesore të studimeve dhe përvojën në punë*).

-Ky raport t’u përcillet zyrtarisht nëpunësve përgjegjës për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës (*eprori direkt i pozicionit respektiv të punës dhe Burimeve njerëzore*), siç përcaktohet në kreun IV, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar.

-Të përfundojë procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës dhe pas kësaj, Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të përgatitë dokumentacionin e domosdoshëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës (*Struktura dhe organika e hollësishme e institucionit që është në fuqi në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit dhe përshkrimet e punës për vendet e punës pjesë e shërbimit civil*).

Ky dokumentacion, nëpërmjet Zyrës së Arkiv Protokollit, t’i përcillet Komitetit të Vlerësimit dhe Klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil i cili duhet të konfirmojë me shkrim marrjen e tij.

-Komiteti i Vlerësimit dhe Klasifikimit të pozicioneve, i cili aktualisht është ngritur me Urdhërin nr. 385 datë 27.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë, pas administrimit të dokumentacionit të domosdoshëm, të identifikojë me saktësi vendet e punës që do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit/rivlersimit. Më tej, do të vijojë punën me vlerësimin/rivlersimin e tyre, duke u bazuar në përshkrimet e punës dhe në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në lidhjen nr. 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar.

-Në përfundim të procesit të vlerësimit, të hartohet një listë përmbledhëse ku të pasqyrohen pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, të klasifikuara në kategorinë dhe klasën përkatëse sipas klasave të zbatueshme për secilën kategori, të përcaktuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe pikën 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar.

-Lista përmbledhëse e klasifikimit racional në kategorinë dhe klasën përkatëse për gjithë pozicionet e shërbimit civil të strukturës që është në fuqi në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit, t'i përcillet nëpërmjet Zyrës së Arkiv Protokollit, Titullarit të institucionit dhe Njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore.

Për realizimin e kësaj detyre në përputhje me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, Komiteti i Vlerësimit dhe Klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, të bashkëpunojë dhe këshillohet me Departamentin e Administratës Publike, siç përcaktohet në pikën 37, kreu V, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar.

- Pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të hartohet dhe miratohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil ku të shpallen për konkurrim të gjitha vendet vakante të shërbimit civil. Në këtë akt të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit, duke miratuar një planifikim të qartë të këtij procesi ku të përfshihet pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi.

3. Pasi të përmbyllet procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, Kryetari i Bashkisë Tropojë, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit, për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në këtë ligj, sipas planit të miratuar nga Komisioneri, në pozicione pune të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues dhe ekzekutive, që aktualisht janë **27 raste**, të evidentuara nominalisht më poshtë, për pozicionet e punës ku janë të emëruar këta punonjës:

- **Elisabeta Selimaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist për Arkën dhe Magazinën*”, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës, me aktin nr. 28, datë 05.06.2024, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Adriana Selivrada**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Zyrës së Zhvillimit Ekonomik*”, në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Prokurimeve Publike, në Drejtorinë Ekonomike, me aktin nr. 293, datë 09.09.2023, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Malvina Gjonaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist për Prokurimet Publike*”, në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria Ekonomike, me aktin nr. 21, datë 24.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Enxhi Brahaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Tatim Taksave*”, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Drejtorinë Ekonomike, me aktin nr. 106, datë 20.03.2024, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Bujar Bashukaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Tatim Taksave*”, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Drejtorinë Ekonomike, me aktin nr.168, datë 30.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë.

- **Elisabeta Gjocaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Menaxhimit të Borxhit*”, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Drejtorinë Ekonomike, me aktin nr.17, datë 02.04.2024, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Rovena Doçi**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Menaxhimit të Taksës Familjare*”, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Drejtorinë Ekonomike, me aktin nr. 320 datë 24.12.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Erblina Pali**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Ndihmës Ekonomike dhe Ivaliditetit*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, Paaftësisë dhe invaliditetit, Drejtoria Ekonomike, Njësia Administrative Margegaj, me aktin nr. 28 datë 27.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Iliriana Ismailisufaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Ndihmës Ekonomike*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, Paaftësisë dhe invaliditetit, në Drejtorinë Ekonomike, me aktin nr. 82 datë 20.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Fjoralba Matoshi**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Ndihmës Ekonomike dhe Ivaliditetit*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, Paaftësisë dhe invaliditetit, Drejtoria Ekonomike, Njësia Administrative Llugaj, me aktin nr. 361 datë 21.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Ervin Gjonpalaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Ndihmës Ekonomike dhe Ivaliditetit*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, Paaftësisë dhe invaliditetit, Drejtoria Ekonomike, Njësia Administrative Fierzë, me aktin nr. 25/1, datë 30.08.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Time Kuçana**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*”, në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, me aktin nr. 68 datë 03.04.2023, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Endri Musaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*”, në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e PZHT, me aktin nr.10 datë 15.02.2024, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Erion Matoshi**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*”, në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, me aktin nr.46/1 datë 18.06.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Floralda Tabaku**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, me aktin nr. 114, datë 08.09.2023, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Flutura Vatoci**, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin Juridik dhe Apeliimi Tatimor, me aktin nr. 117, datë 16.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Besar Haxhiaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin Juridik dhe Apeliimi Tatimor, me aktin nr. 57, datë 21.02.2023, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Ilirjan Ismailisufaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin Juridik dhe Apeliimi Tatimor, nëpërmjet aktit nr. 24, datë 28.02.2025, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Juliana Gjyriqi**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Çështjeve të Migracionit dhe Diasporës*”, në Sektorin e Integrimit Evropian, Çështjeve të Migracionit, Diasporës dhe Ndihmës së Huaj, me aktin nr. 294, datë 09.09.2024, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Aranit Imeraj**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Turizmit*”, në Drejtorinë e Turizmit, Shërbimeve, Publike dhe Transportit me aktin nr. 40, datë 12.02.2024, të Kryetarit të Bashkisë.

- **Ardit Qehaja**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Menaxhimit të Pyjeve*”, në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Kullotave dhe Bujqësisë, me aktin nr. 31, datë 09.09.2024, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Ramiz Sokolaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Menaxhimit të Pyjeve*”, në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Kullotave dhe Bujqësisë, me aktin nr. 296, datë 21.02.2023, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Flutura Haxhiaj**, emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë Ekonomike, me aktin nr.232, datë 08.06.2023, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Ndriçim Gjoçaj**, emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Transportit, me aktin nr. 29, datë 28.02.2025, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Kujtim Baliaj**, emëruar në pozicionin “*Drejtor*” në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Kullotave dhe Bujqësisë, me aktin nr. 296, datë 09.09.2024, të Kryetarit të Bashkisë.
- **Muhamet Kuçana**, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Pronave dhe Hartografisë, me aktin nr. 516, datë 19.09.2022 (nr. 15545 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
- **Jetnor Tafaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Menaxhimit të Pyjeve*”, në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Kullotave dhe Bujqësisë, me aktin nr. 296, datë 21.02.2024, të Kryetarit të Bashkisë.

Ky veprim do të rivendosë situatën e ligjshmërisë dhe do të mundësojë procesin e rekrutimit sipas parimeve të ligjit për nëpunësin civil dhe kërkesave specifike që rregullojnë këtë institut të ligjit.

4. Njësia përgjegjëse e institucionit, të hartojë një plan veprimi për zbatimin e këtij vendimi paralajmërues, i cili duhet të miratohet nga Kryetari I Bashkisë, ku të përcaktohen qartë: a) veprimet administrative që do të kryhen në zbatim të detyrave të lëna në raportin përfundimtar dhe në këtë vendim; b) subjekti/ nëpunësi përgjegjës për kryerjen e veprimit; si dhe c) afati/data brenda të cilës do të përfundojë kryerja e veprimit administrativ. Në këtë akt do të parashikohet edhe radha e kryerjes së konkurremeve për pozicionet e punës të cilat aktualisht janë të plotësuara në kundërshtim me ligjin, të evidentuara në pikën **3** të këtij vendimi. këtij vendimi.

Plani i veprimit do të dërgohet pranë Komisionerit 2 muaj, pas marrjes dijeni për këtë vendim paralajmërimi.

5. Të anulohen aktet administrative: nr. 243 prot., datë 12.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për emërimin e punonjësës **Shkurte Gjoka**, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike*”, kategoria III-a dhe nr. 247 prot., datë 12.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë, për emërimin e punonjësit **Guxim Kojeli**, në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Integritimit European dhe Nidhmës së Huaj*”, kategoria III-a, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin, si dhe të përsëritet procedura përkatëse, duke filluar nga faza e Ngritjes së Komitetit të Pranimi për Ngritjen në Detyrë (KPND) sipas përcaktimeve të ligjit, dhe akteve nën ligjore që rregullojnë këtë institut të ligjit.

6. Të finalizohet nga eprori direkt dhe njësia përgjegjëse procesi i periudhës së provës, sipas orientimeve të dhëna në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes, për **3** nëpunësit e emëruar për herë të parë në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil:
- Suela Abdullai, emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist Pagash në Sektorin e Buxhetit dhe Financës*”, me aktin nr. 245, datë 12.01.2024 të njësisë përgjegjëse.
 - Florian Metaliaj, emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist Pyjesh në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor*”, me aktin nr. 3, datë 12.01.2024 të njësisë përgjegjëse.
 - Zamira Ismailisufaj, emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist për Arsimin Kulturën dhe Sportin pranë Drejtorisë Ekonomike*”, me aktin nr. 9, datë 12.02.2024 të njësisë përgjegjëse.
 - Me përmbushjen e detyrimeve ligjore, eprori duhet të përmbyllë procesin në një nga këto mënyra të parashikuara në ligj: a) konfirmimin e nëpunësit civil, nëse ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm në ASPA, dhe është vlerësuar të paktën “kënaqshëm”; b) zgjatjen një herë të vetme deri në 6 (gjashtë) muaj të periudhës së provës, në rastet kur nuk përfundon me sukses trajnimi i detyrueshëm në ASPA ose nuk është e mundur të vlerësohet nëpunësi, pasi eprorit i nevojitet më shumë kohë për të vlerësuar nëpunësin, *(rastet e mungesës në detyrë të nëpunësit për shkak të trajnimit afatgjatë, raportit mjekësor afatgjatë dhe në raste të tjera, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të cilat rregullojnë mungesën në detyrë të nëpunësit)* dhe c) moskonfirmimin e nëpunësit civil.
 - Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në rastin e konfirmimit të nëpunësit civil nga eprori direkt, të nxjerrë aktin për deklarimin e statusit të nëpunësit, sipas përcaktimeve të pikës 13, të kreut VI, të VKM nr. 243, dt. 18.3.2018, i ndryshuar.
7. Të plotësohet dosja e personelit nga ana e njësisë përgjegjëse, sipas shkronjës “gj”, të VKM-së nr. 833, dt. 28.10.2020, “*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjes së personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, me akte që materializojnë gjëndjen shëndetësore të nëpunësit civil, të tilla si: Raporti i lëshuar nga Komisioni Mjeko Ligjor, dhe Raporti për kryerjen e kontrollit bazë.
8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet që vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna.

9. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Tropojë, Prefekti i Qarkut Kukës, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Tropojë, duhet të njoftojë për këtë vendim, çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin si dhe çdo subjekt tjetër i cili është ngarkuar me detyra të posaçme, në raportin përfundimtar dhe në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

10. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)